


**RAPORTI**  
**I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**  
**Për Programin e studimit Bachelor në**  
**Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci**  
**Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë**

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Enri Hide



Dr. Dhurata Milori



(Korrik/2018)

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit BSc Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci**

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
3	Urdhëri/VKM i licencimit/ Riorganizimit i programit nga DNP në Bsc	VKM Nr.177 dt.19.02.2009 Urdhër të Ministrit Nr. 383 dt. 05.08.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër të Ministrit Nr.124 dt 29.03.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike/6 semestra
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
16	Numri i studentëve	124 studentë

## HYRJE

### Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci

Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" ka filluar aktivitetin me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.177 dt.19.02.2009 si "Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë". "Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë" është akredituar institucionalisht me urdhër Nr.124 dt 29.03.2012 mbështetur në vendimin Nr.303 dt 13.01.2012.

Me Urdhër të Ministrit Nr. 383 dt. 05.08.2011, mbështetur në VKA Nr. 198 dt. 24.06.2011, "Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë" ka riorganizuar programet e saj të studimit nga DNP në Bachelor. Me Urdhër të Ministrit Nr.124 dt 29.03.2012 mbështetur, Institucioni është akredituar institucionalisht dhe në programet Bachelor. Me Urdhër të Ministrit Nr 278 dt 19.05.2017, "Miratimin e Statutit të Universitetit "Mesdhetar i Shqipërisë" institucioni funksionon si Universitet.

Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare ka në përbërjen e vet strukturore njësitë e mëposhtme:

- Departamentin e së Drejtës Publike;
- Departamentin e së Drejtës Civile dhe
- Departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare;

Bazuar në Ligjin Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë kërkoi riorganizimin e njëres prej njësive të saj kryesore, "Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Politike". U kërkua që mbi bazën e tij, të miratohej krijimi i dy njësive kryesore, "Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike" dhe "Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare". Posaçërisht, të miratohej krijimi i "Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare". Ndërkohë pjesa tjetër e Me, të, Mbi bazën e kërkesës së mësipërme dhe vlerësimit pozitiv të dokumentacionit të paraqitur nga ana e UMSH, Ministria e Arsimit dhe Sportit, me urdhrin e saj Nr.273, datë 18.05.2017, miratoi krijimin e tyre.

Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, përfaqëson një nga njësitë kryesore të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Për realizimin e qëllimeve dhe objektivave të veta ai aktivizon personalitete akademike dhe specialistë nga më të njohurit në fushat fundamentale të jurisprudencës dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë. Në këtë mënyrë synohet drejt formimit të qëndrueshëm në fushën e drejtësisë dhe të drejtës, si dhe të studimeve ndërkombëtare dhe diplomacisë, në përputhje me standardet europiane dhe përvojat e vendit, duke zbatuar specifikat përkatëse në lidhje me arsimin ligjor. Në këtë fakultet, ofrohen mundësi për punë kërkimore dhe zhvillim kulturor në kontekstin e gjerë të dukurive të shumëllojshme shoqërore, të para këto në kontekstin rajonal dhe ndërkombëtar.

### GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akteditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof. Asoc. Dr. Enri Hide dhe Dr. Dhurata Milori ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi.

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Znj. Xhiliola Bixheku.

Me datë 23.07.2018 dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të jashtëm i Hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Më datë 31.07.2018 Institucioni sjell në ASCAL komentet në lidhje me Draft – RVJ. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe vendosën të mos i marrin në konsideratë ato. Draft-RVJ kthehet në Raport përfundmtar.


## ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

### I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Të shikohet mundësia që në planin mësimor të këtij programi studimi, të zgjerohet lista e lëndëve me zgjedhje.
- b) Të pasurohet biblioteka me tituj dhe autorë me identitet shkencor të konsoliduar
- c) Të vendoset si kriter specific për pranimin e studentëve, gjuha e huaj angleze.
- d) Të synohet rekrutimi i personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, në favor të të parëve.
- e) Të synohet rritja e nivelit të bashkëpunimit me grupet e interesit dhe sektorin publik.
- f) Të synohet rritja e debatit shkencor në shkallë institucioni dhe në rang vendi.

### II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin “Të shikohet mundësia që në planin mësimor të këtij programi studimi, të zgjerohet lista e lëndëve me zgjedhje”, vërehet se ky program studimi nuk përmban në programin e tij lëndë me zgjedhje por ato ju bëhen të mundura studentëve nga programet e tjera të studimit brenda këtij Fakulteti. **Rekomandimi plotësohet pjesërisht.**
- b) Për rekomandimin “ Të pasurohet biblioteka me tituj dhe autorë me identitet shkencor të konsoliduar”, gjatë vizitës u vërejt se biblioteka ka shtuar numrin e autorëve dhe të teksteve të rëndësishme për formimin akademik të studentëve, duke përfshirë disa nga autorët më të njohur në këtë fushë. **Rekomandimi plotësohet plotësisht.**
- c) Për rekomandimin “Të vendoset si kriter specific për pranimin e studentëve, gjuha e huaj angleze”, UMSH për realizimin e tij përvec modulit “Gjuhë e huaj” angleze në vitin e parë ka përfshirë dhe në vitin e tretë modulën Gjuhë Angleze për Marrëdhënie Ndërkombëtare për të rritur nivelin e njohurive të studentëve në këtë fushë. Megjithatë rekomandimi nuk është kthyer ende në një kriter specific për pranimin e studentëve në këtë program studimi . Bazuar në lëgjislacionin aktual për arsimin e lartë, studentët e nivelit Bsc nuk e kanë detyrim pranimit gjuhën e huaj. **Rekomandimi plotësohet plotësisht.**
- d) Për rekomandimin” Të synohet rekrutimi i personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, në favor të të parëve” vërehet se UMSH e ka rritur numrin e stafit të brendshëm



në rang institucional. Gjitashtu në këtë program studimi janë angazhuar edhe personalitete të fushës e cila përbën një vlerë të shtuar për programin e studimit. **Rekomandimi plotësohet plotësisht.**

- e) Për rekomandimin “Të synohet rritja e nivelit të bashkëpunimit me grupet e interes dhe sektorin publik” janë bërë përpjekje për ta rritur bashkëpunimin ku kanë qenë vecanërisht të frytshme në nivelin kombëtar me Akademinë Diplomatike të Ministrisë së Jashtme dhe në nivelin ndërkombëtar me London Academy of Diplomacy. Përpjekja rekomandojmë të intensifikohet më tej për të qenë sa më e vlefshme si për studentët por edhe për pedagogët e departamentit. **Rekomandimi është plotësuar kryesisht.**
- f) Për rekomandimin “Të synohet rritja e debatit shkencor në shkallë institucioni dhe në rang vendi” vërehet se UMSH zhvillon në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme leksione të hapura, simpozium, seminare si dhe Konferenca Ndërkombëtare dhe Ndërkombëtare. Rekomandojmë që të ruhet dhe intensifikohet më tej përpjekja për ta ngritur më tej këtë debat në rang vendi. **Rekomandimi plotësohet kryesisht.**



## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci është ofruar për herë të parë në UMSH në vitin akademik 2009-2010.

Objektivi kryesor i programit të ciklit të parë Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci është t'i pajisë studentët me njohuritë themelore për formimin e tyre në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë. Ky program i ndihmon ata dhe në vazhdimin e studimeve të mëtejshme pasuniversitare apo të avancuara në fushën marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë.

Për formimin e studentëve një vëmendje e veçantë i kushtohet thellimit të njohurive në një grup lëndësh kryesore si: Teoria e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Historia e Diplomacisë, E Drejta Ndërkombëtare, Studime Evropiane, Analiza e Politikës së Jashtme etj.

Ndërtimi i këtij programi studimi me një grup lëndësh kryesore si të mësipërmet i jep mundësi studentit për ndjekjen e një karriere kërkimore apo akademike nëpërmjet vazhimit të studimeve të masterit shkencor, ose të studimeve të një masteri profesional, jo vetëm në fusha shkencore të përafërta me marrëdhëniet ndërkombëtare dhe diplomacinë por edhe në Ekonomi Ndërkombëtare, Histori, Studime Evropiane apo Shkenca Politike.

Ky program studimi e aftëson studentin për ti dhënë mundësi dhe aftësuar atë për tu punësuar si në sektorin publik dhe në atë privat. Fushat kryesore të punësimit të cilat përputhen me njohuritë e marra dhe programin e zhvilluar janë: Administratë publike në nivel qendror e lokal, organizata të ndryshme ndërkombëtare, institute kërkimi, media, fondacione. Ky formim i shumëanshëm teorikisht ju mundëson studentëve një orinetim të drejtë në tregun e punës.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	Programi i studimit Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e UMSH. Programi i Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci është përpjekur ti përgjigjet nevojave të vendit në fushën përkatëse duke futur në programin e studimit ato lëndë që janë të nevojshme jo vetëm për formimin profesional por edhe t'ju lehtësojë punësimin studentëve të diplomuar. UMSH në këtë program studimi reflekton nevoja që lindin nga zhvillimi dhe progresi i vendit dhe i rajonit.
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;	
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
<b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve hartohen në	

përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.	
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit Bachelor Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci përputhet me planin strategjik 5 vjeçar të zhvillimit të UMSH. Program studimi është gjithashtu në përputhje me programin e kërkimit shkencor të përcaktuara të UMSH si dhe me standartet e Kartës së Bolonjës. Programi Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci synon të pajisë studentët me përgatitjen teorike për të njohur, analizuar dhe krahasuar zhvillimet ndërkombëtare. Ky program gjithashtu synon tu japë njohuri studentëve mbi teoritë e integritit me fokus të vencantë në integrimin europian si dhe me funksionimin e institucioneve dhe legjislacionin e BE-së. Nëpërmjet këtij programi studimi studentët marrin njohuri mbi organizimin dhe funksionimin e organizatave ndërkombëtare rajonale dhe globale. Synim i rëndësishëm i këtij programi studimi mbetet aftësiimi i studentëve për të analizuar zhvillimet ndërkombëtare si dhe ti pajisë studentët me njohuritë e nevojshme mbi metodologjinë e kërkimit shkencor të shkencave sociale në përgjithësi dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare në vecanti duke patur si qëllim vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë (Master i Shkencave dhe Master Profesional).</p>
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>Ky program studimi në mënyrën e organizimit të programit të tij mësimor i aftëson studentët për tregun e punës në këtë fushë specifike duke përgatitur specialistë në fushë e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë që do të jenë të aftë dhe do të kenë kapacitet e nevojshme që të hynë në tregun e punës në shqipëri dhe jashtë saj.</p> <p>Universiteti regjistron çdo vit student në bazë të kuotave të propozuara dhe miratuara nga Ministria përkatëse.</p> <p>Universiteti ka krijuar mekanizma të studimit të tregut dhe është përpjekur të përshtasë kurrikulën me tregun e punësimit. Duke qenë se një studim i tillë i mirëfilltë mungon kjo mund të reflektohet më pas dhe në analizimin e mirëfilltë dhe pasqyrimin e drejtë të tyre në kurrikulën mësimore të këtij programi studimi.</p>
<b>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p>	<p>Programi Bachelor Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci zhvillohet dhe është në përputhje të plotë me kuadrin ligjor duke përfshirë ligjet në fuqi,</p>

**Kriteri 2** Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.

strategjinë kombëtare për zhvillim dhe Integrim european. Ky program mban në konsideratë vlerat kulturore kombëtare. Programi gjithashtu nëpërmjet lëndëve të zhvilluara aftëson brezin e ri për tu bërë në të ardhmen pjesë e proceseve shumë të rëndësishme për vendin si integrimi në BE, marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet e tjera si dhe forcimin e imazhit të diplomacisë shqiptare.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Programi i studimit Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci është një program i cili zhvillohet në përputhje me ligjin e Arsimit të lartë, strategjinë kombëtare për zhvillim dhe Integrim, rregulloren dhe strategjinë e UMSH.
2. Objektivat e këtij programi studimi janë të mirëpërcaktuara dhe synojnë përgatitjen sa më të mirë me dije të studentëve për ti aftësuar dhe bërë ata konkurrues me tregun e punës si brenda dhe jashtë vendit.
3. Programi i studimit i jep mundësi studentit për ndjekjen e një karriere kërkimore apo akademike nëpërmjet vazhdimin të studimeve të masterit shkencor, ose të studimeve të një masteri profesional, jo vetëm në fusha shkencore të përafërta me marrëdhëniet ndërkombëtare.

**Standardet përmbushen**

**2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)**

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** përbërësit e njësive dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësive, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare është një prej tre fakulteteve që përbejnë UMSH. Ky Fakultet përbëhet nga tre departamente: Departamenti i të Drejtës Publike, Departamenti i të Drejtës Civile dhe Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Fakulteti gjatë viteve i është nënshtruar disa ndryshimeve strukturore. Këto ndryshime kanë patur për qëllim sigurimin e një cilësie sa më të mirë të programeve të studimit, në përgjigje të kërkesave të tregut. Gjithashtu ky ndryshim dhe riorganizim ka patur për qëllim krijimin e lidhjeve më të mira të programit të studimit dhe të diplomave të lëshuara. Në këtë kuadër nga Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike sot quhet Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare synon të përgatisë juristë, diplomatë, studiues të shkencave të përafërta me to dhe specialistë të administratës publike. Synim i rëndësishëm i Fakultetit mbetet dhe zhvillimi i kërkimit shkencor në fushën e drejtësisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.



Programet e studimit të ofruara nga fakulteti janë: 2 programe studimi të Ciklit të Parë (BA); 3 programe studimi të Ciklit të Dytë Master i Shkencave (MSH), 1 program të Ciklit të Dytë Master Profesional me dy profile (MP).

Programi mësimor realizohet nga angazhimi i personelit akademik i cili përbëhet nga 37 pedagogë, nga të cilët 26 të brendshëm dhe 11 të jashtëm.

Fakulteti angazhohet të mbajë një bazë të dhënash të njësisë të përditësuar vazhdimisht. Gjithashtu nga vizita e realizuar konkludojmë se departamentet e posacme brënda këtij Fakulteti mbajnë përgjegjësinë e transparencës dhe gatishmërisë për dhënien e informacionit të të interesuarve për programet e studimit.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Struktura akademike e Fakultetit


Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare përbëhet nga tre departamente: Departamenti i të Drejtës Publike, Departamenti i të Drejtës Civile dhe Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Në total numri i pedagogëve të tre departamenteve është 37. Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Departamenti i të Drejtës Publike kanë secili në total 13 pedagogë. Departamenti i të Drejtës Civile ka të angazhuar në total 11 pedagogë. Në Departamenti e Marrëdhënieve Ndërkombëtare janë të angazhuar 8 pedagogë si personel akademik efektiv prej të cilëve 4 me grada shkencore dhe 5 pedagogë të angazhuar si personel akademik me kontratë prej të cilëve 4 me grada shkencore.

Në Departamentin e të Drejtës Publike janë angazhuar 9 pedagogë si personel akademik efektiv prej të cilëve 8 me grada shkencore dhe 4 pedagogë si personel akademik me kontratë, prej të cilëve 2 me grada shkencore.

Departamenti i të Drejtës Civile ka të angazhuar 9 pedagogë në cilësinë e personelit akademik efektiv ku 4 prej tyre mbajnë grada shkencore dhe 2 pedagogë në cilësinë e personelit akademik me kontratë me grada shkencore.

Në total Fakulteti ka të punësuar 37 pedagogë. 26 pedagogë janë të angazhuar si personel akademik efektiv ku 16 prej tyre mbajnë grada shkencore. Pedagogët të cilët janë të angazhuar si personel akademik me kontratë janë 11, prej të cilëve 8 janë me grada shkencore. Në total pedagogët, qoftë staf akademik efektiv apo me kontratë, të cilët mbajnë grada shkencore në këtë Fakultet janë 24.

Rektori, zv/rektori, dekani dhe shefat e departamenteve janë organet drejtuese të fakultetit të emëruar sipas Ligjit Nr.80/2015 për Arsimit e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë dhe janë punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimit:



Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci. Rektori mban titullin Prof. As., Dekani i Fakultetit mban titullin Prof. Dr dhe shefi i Departamentit mban gradën PhD.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare ka të angazhuar gjithësej 13 pedagogë, prej të cilëve 8 pedagogë janë staf akademik efektiv dhe 5 pedagogë janë staf akademik me kontratë. Në stafin akademik efektiv 2 pedagogë kanë gradën shkencore Phd, 2 pedagogë janë kandidatë për Phd, 1 pedagog mban gradën shkencore Dr dhe 3 pedagogë janë Msc. Përsa i përket stafit akademik me kontratë 1 pedagog mban gradën shkencore Prof.Dr, 2 pedagogë mbajnë gradën shkencore Prof.Asoc.Dr, 1 pedagog mban gradën shkencore Dr dhe një prej tyre Msc. Në stafin akademik të këtij programi vërehen pedagogë të cilët kanë një kontribut dhe eksperiencë të gjatë në fushat përkatëse ku ushtojnë mësimdhënien, gjë e cila mbetet një vlerë e shtuar për vet Departamenti por edhe për programin e studimit.

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli akademik i Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Diplomaci është pjesë e personelit akademik të Departamentit të Marrëdhënieve ndërkombëtare. Ai ndahet në dy kategori: personel akademik dhe ndihmës mësimor shkencor, ndërsa nga pikëpamja e angazhimit kontraktual pranë institucionit, personeli ndahet në dy kategori: PAE dhe PAK. PAE përbëhet nga 16 pedagogë, kurse PAK përbëhet nga 3 pedagogë. Prej stafit PAE, 2 me titullin Profesorë, 6 Doktorë Shkencash dhe PhD, 6 kandidatë për Doktorë Shkencash, 3 asistentë pedagogë me titullin Master Shkencor. Tre anëtarët e stafit PAE mbajnë titujt shkencorë: 1 Profesor i Asociuar, 1 Doktor Shkencash dhe 1 Master Shkencor. Vihet re se stafi ka mangësi anëtarësh PAE me gradën shkencore Profesor i Asociuar (nuk ka asnjë), çka tregon dhe një diferencë brezash pasi përbërja moshore tregon një shpërndarje të konsiderueshme midis grupmoshës 36-45 dhe 66-68. Kjo diferencë mund të kapërcehet me punësimin e PAE me gradë shkencor

Profesor i Asociuar. Raporti midis PAE dhe PAK është 16/3 ose rreth 5 PAE për çdo PAK. Raporti midis PAE femra dhe meshkuj është përkatësisht: 6/10, çka nxjerr në pah nevojën për më shumë barazi gjinore në të ardhmen. Raporti midis personelit akademik, personelit administrativ dhe studentëve është i kënaqshëm. Pranë këtij programi studimi funksionojnë 12 persona si personel administrativ (PA), që kontribuojnë në mbarëvajtjen e proceseve akademike e mësimdhënëse. Gjatë dy viteve të fundit akademike numri i PAE ka ndryshuar relativisht pak, sikundër edhe pedagogët e programit, duke treguar një stabilitet i cili ndihmon në zhvillimin e mëtejshëm të programit.

Ngarkesa e stafit akademik është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në shumë raste edhe nivele mjaft të mira persa i takon oreve mësimore, duke marrë këtu parasysh edhe ngarkesën akademike që ata mund të kenë në programe të tjera të IAL. Kështu pjesa më e madhe e PAE me gradën doktor kanë një ngarkesë më të ulët se 200 orë, ndërsa përgjegjësi i departamentit ka një ngarkesë të përgjithshme prej 195 orësh, çka i krijon mundësinë që të mbulojë edhe aspektet administrative të pozicionit.<sup>1</sup> Po kështu edhe ngarkesa e PAK është më pak se një ngarkesë e plotë mësimore dhe PAK të cilët mbajnë gradën Profesor.

Kriteret e punësimit të personelit akademik janë kryer në përputhje me normat dhe dispozitat ligjore si dhe ka një përshkrim të qartë të detyrimeve të palëve gjatë zhvillimit të procesit kontraktual. Në dokumentacionin e paraqitur, nga IAL në dokumentin me titull Kontrata e Punës janë paraqitur dy tipologji të vecanta kontratash për personelin PAE dhe PAK. Kjo edhe duke patur parasysh profilet, kërkesat dhe angazhimin e ndryshëm të këtyre dy figurave pranë institucionit.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Shih Tabelën1, Tabelën 2, Tabelën 1.1 në Aneks)

Në Tabelat 1, 2 dhe 2.1 të Aneksit, pasqyrohet gjendja e PAE dhe PAK, sipas titujve dhe gradave të tyre. PAE përbëhet nga 16 pedagogë, kurse PAK përbëhet nga 3 pedagogë. Prej stafit PAE, 2 me titullin Profesorë, nuk ka me titull Profesor i Asociuar, 6 Doktorë Shkencash ose PhD, 6 kandidatë për Doktorë Shkencash, 3 asistentë pedagogë me titullin Master Shkencor. Tre anëtarët e stafit PAE mbajnë titujt shkencorë: 1 Profesor i Asociuar, 1 Doktor Shkencash dhe 1 Master Shkencor. Vërehet se një numër pedagogësh vijnë nga departamente

<sup>1</sup> Takimi në institucion me Përgjegjësin e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Dekanin e Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare (dt. 7 qershor 2018).

të tjera të të njëjtit fakultet, pasi për shkak të natyrës ndër-disiplinore të kurrikulës, disa lëndë strehohen pranë departamenteve të tjera.

☒ Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabelat në Aneks)

Stafi akademik mbulon mjaftueshëm nevojat e programit përsa i takon ngarkesës së PAE dhe PAK. Gjithashtu stafet PAE dhe PAK kanë kualifikimet e nevojshme shkencore. Stafi PAE dhe PAK nuk ka patur luhatje të konsiderueshme gjatë viteve për të cilat verifikon ky raport. Në nivel departamenti ka 8 PAE dhe 5 PAK, e cila i korrespondon me një përqindje 62.5% të brendshëm dhe 37.5% të jashtëm. Për sa i përket ngarkesës mësimore rezultojnë se stafi akademik efektiv mbulon mbi 70% të saj. Me tituj dhe grada janë 1 PAE (konkretisht Përgjegjësi i departamentit, Edon Qesari, PHD) dhe 3 PAK (tre Profesorë të Asociuar). Vihet re se stafi ka mangësi anëtarësh PAE me gradën shkencore Profesor i Asociuar (nuk ka asnjë) dhe Profesor (nuk ka asnjë). Kjo mangësi mund të kapërcehet me punësimin e PAE me gradë shkencor Profesor i Asociuar dhe Profesor.

Kjo pasqyrë ndër vitet e akreditimit duke u nisur nga viti akademik 2012-2018 është si vijon:

1. Për vitin akademik 2017-2018 raporti i numrit PAE/PAK është 8/5. Gradat e pedagogëve të programit janë si vijon: PAE janë 4 PhD/Dr., 4 PAE MSc (në procesin e marrjes së gradës Dr/PHD). Ndërsa PAK janë: 1 Profesor, 1 Prof.As., 2 Dr. dhe 1 Msc. Ka një shpërndarje jo të njëtrajtshme ndërmjet gradave të PAE në program sepse në shumicën e tyre janë Doktor Shkencash dhe kandidatë për të marrë këtë titull, por një rritje në krahasim me vitin e mëparshëm si në numër ashtu edhe në cilësi. Ndërsa për PAK mbulohen pothuajse të gjitha gradat përfshirë edhe titullin Profesor dhe Profesor i Asociuar, Dr. dhe Msc, çka është një rritje si sasiore si cilësore në krahasim me vitin e mëparshëm.
2. Për vitin akademik 2016-2017 raporti i numrit PAE/PAK është 9/6. Gradat e pedagogëve të programit janë si vijon: PAE janë 5 PhD/Dr., 4 Msc. Ndërsa PAK janë: 3 Dr, 1 Prof. As., 2 MSC. Ka një mungesë gradash Profesor dhe Profesor i Asociuar për PAE, ndërsa një shpërndarje gradash për PAK.
3. Për vitin akademik 2015-2016 raporti i numrit PAE/PAK është 8/5. Gradat e pedagogëve të programit janë si vijon: PAE janë 1 Profesor i Asociuar, 4 PhD/Dr., 3 MSC. Ndërsa për PAK janë: 2 Prof.As. dhe 3 MsC. Ka një shpërndarje jo të njëtrajtshme ndërmjet gradave të PAE në program sepse në shumicën e tyre janë PhD/Dr. ose në procesin e marrjes së kësaj grade. Ndërsa për PAK mbulohet vetëm grada Profesor i Asociuar (me dy të tillë).
4. Për vitin akademik 2014-2015 raporti i numrit PAE/PAK është 7/6. Gradat e pedagogëve të programit janë si vijon: PAE janë: 1 Profesor, 1 Prof. Asoc., 4 PhD/Dr., 2 Msc. Ndërsa për PAK janë: 1 Prof. Asoc. 2 Dr. dhe 3 Msc. Ka një shpërndarje jo të njëtrajtshme ndërmjet

gradave të PAE në program sepse në shumicën e tyre janë PhD/Dr. Ndërsa për PAK mbulohen të gjitha gradat, me përjashtim të titullit Profesor.

5. Për vitin akademik 2013-2014 raporti i numrit PAE/PAK është 7/6. Gradat e pedagogëve të programit janë si vijon: PAE janë 1 Profesor, 3 PhD/Dr. dhe 3 Msc. Ndërsa për PAK janë: 3 Dr dhe 3 Msc. Ka një mangësi titujsh Profesor në PAK.
6. Për vitin akademik 2012-2013 institucioni nuk ka paraqitur të dhëna për stafin akademik PAK dhe PAE.

- Të dhënat sipas seksit


Në këtë program studimi ekziston një raport 6/10 (femra/meshkuj) për stafin PAE. Ka nevojë që ky raport të përmirësohet në perspektivë, për të garantuar një barazi gjinore më të plotë, jo vetëm të stafit PAE, por edhe të PAK.

- Të dhëna sipas moshës së personelit ( Aneks Tabelat 6 dhe 7)

Sipas të dhënave të depozituara në Tabelat 5 të Aneksit, moshë mesatare e PAE është më e lartë për grupmoshat 25-35 dhe 36-45, çka reflekton përgjithësisht dhe moshën relativisht të re të stafëve akademike në Shqipëri, sidomos në dhjetëvjeçarin e fundit. 5 pjesëtarë PAE kanë moshë mesatare 25-35. 8 të tjerë i përkasin grup-moshës 36-45 vjeç, ndërsa vërehet një hendek brezash për grupmoshat 46-68 vjeç. Kjo tregon se ekziston nevoja që të ketë një përfaqësim brezash më të plotë dhe një kalim gradual të stafetës akademike mes tyre.

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Konstatohet një tipologji e vecantë kontrate për PAE dhe PAK, të cilat për vetë natyrën e tyre duhet të kenë karakteristika të vecanta duke filluar nga periudha e provës deri tek nevoja a ripërtëritjes vjetore të saj. Në kontratat e punës identifikohen qartë detyrat dhe detyrimet që rrjedhin prej saj për të dyja palët, sikurse dhe të drejtat që gëzon secila palë. Kontratat janë në përputhje me kriteret ligjore të punësimit në arsimin e lartë, përmes procedurave transparente dhe në përputhje me ligjin e punës së Republikës së Shqipërisë.



Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë:

Stafi administrativ është i organizuar në disa nivele. Në nivelin administrativ, cdo fakultet dhe departament kanë administratore të përkatës. Funksionon gjithashtu edhe zyra e Këshillimit të Studenteve dhe të Karrierës, e cila bashkëpunon me një staf-ndihmës pranë cdo departamenti për të koordinuar punën lidhur me nevojat e studentëve. Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë është një tjetër strukturë brenda IAL, që fokusohet kryesisht në programet ndërkombëtare dhe së bashku me Zyrën e Projekteve mbështet pjesëmarrjen e pedagogëve dhe studenteve në këto programe. Zyra e IT mbulon kryesisht infrastrukturën e IAL por edhe ndihmon në mbarëvajtjen e leksioneve (prezantimet, modulet IT brenda programit etj). Pedagogët dhe studentet kanë edhe ndihmën e Sekretarise së Pranimit por edhe Sekretarisë Mësimore pranë cdo fakulteti. Strukturat ndihmëse ofrojnë gjithashtu mundësinë për studentet për të marrë pjesë në internship të organizuara pranë këtyre strukturave.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>III - PERSONELI I INSTITUCIONIT</b>	
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	Institucioni ndjek një sërë procedurash transparente lidhur me rekrutimin e personelit për këtë program studimi, të cilat përfshijnë lajmërimet në mediat elektronike dhe të shkruara, si dhe procesin e intervistimit dhe kontraktimit të stafit. Këto procedura janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe përputhen gjithashtu me statutin dhe rregulloren e institucionit. Siç rezultoi edhe nga takimi me stafin PAE në institucion (dt. 7 qershor 2018), ky proces është ndjekur rigorozisht prej institucionit. Personeli PAE mbulon mbi 70% të ngarkesës mësimore të programit të studimit, kjo në përputhje me kriteret ligjore të angazhimit të tij në ciklin e parë. Vlerësimi i personelit zhvillohet në mënyrë transparente e të shumëfishhtë. Ai kryhet nëpërmjet: i) plotësimit të "Aneksit A" të kontratës, përmes vetëdeklarimit, ii) nëpërmjet pyetësorëve që plotësojnë studentët në auditor gjatë javës së fundit (ose në provim) (kjo rezultoi edhe nga takimi me studentët, dt. 7 qershor 2018), iii) vlerësimit nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit; iv) vlerësimit nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Vlerësimet janë tërësisht transparente, pasi ato u vihen në dispozicion pjesëtarëve të stafit akademik dhe diskutohen me ta. Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, njoftimeve për punë, etj, e cila ndodhet pranë zyrës së personelit. Kjo u verifikua edhe
<b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;	
<b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;	
<b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.	

	nga vizita në institucion, (dt. 08 qershor 2018).
<b>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore "Doktor,, ose titullin akademik "Docent,,</p>	<p>Institucioni disponon një bazë të dhënash të detajuara për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit Bachelor për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci. Këto gjenden të arkivuara pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore.</p> <p>Institucioni disponon një listë të plotë të personelit akademik, atij ndihmës mësimor dhe administrativ, të cilën e ka vënë në dispozicion të GVJ-së gjatë vizitës pranë institucionit, si dhe e ka paraqitur në formën e tabelave në Aneksin në fund të këtij raporti.</p> <p>Konstatohet se institucioni i ka publikuar kriteret dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik në mediat elektronike dhe ato të shkruara, në mënyrë periodike dhe të zgjeruar.</p> <p>Nga verifikimi i RVB-së rezulton se titullarët e lëndëve e moduleve për programet e studimit të ciklit Bachelor kanë minimalisht gradën Doktor ose Docent.</p>
<b>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Institucioni ofron një kuadër të plotë laboratorik ku angazhohet edhe personeli ndihmës mësimor-shkencor, sidomos në përdorimin e laboratorëve kompjuterikë dhe në kryerjen e orëve praktike. Personeli ndihmës luan rol gjithashtu në mirëmbajtjen e godinës dhe mjediseve të tjera ndihmëse.</p> <p>Konstatohet se departamenti ka kapacitete të mjaftueshme të stafit akademik dhe personelit ndihmës mësimor-shkencor për të vënë në dispozicion të studentëve si mbikëqyrës të praktikës profesionale. Kjo e fundit është rregulluar nëpërmjet formateve që studentët plotësojnë dhe ndjekjes në institucione nga stafi.</p>
<b>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik institucioni organizon seminare trajnuese me personelin akademik, për kualifikimin e tyre të mëtejshëm. Gjithashtu ai ka ndërtuar politika nxitëse për pjesëmarrjen e stafit të tij akademik dhe ndihmës në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Konstatohet gjithashtu se institucioni ka ndërtuar një bazë të gjerë e të plotë të dhënash rreth programeve të studimeve të ofruara, me mundësitë e punësimit dhe konsultimin e studentëve për tregun e punës.</p>

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Institucioni zbaton politika të qarta e transparente të rekrutimit të stafit edhe nëpërmjet publikimit të rregullt në media të pozicioneve të hapura.
2. Institucioni ka kapacitetet e mjaftueshme PAE dhe PAK për të zhvilluar me sukses programin e studimit në Bachelor Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci.
3. Vërehet megjithatë një mungesë e brezit të ndërmjetëm të pedagogëve, në karrierë, të grupmoshës 45-68, çka sugjerohet që institucioni duhet të kujdeset në të ardhmen për mbushjen e këtij hendeku.
4. Sugjerohet gjithashtu që të punohet në drejtim të një balance më të drejtë gjinore brenda departamentit.

#### **Standardet përmbushen**

#### **4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

##### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Nga pikëpamja e infrastrukturës, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është i pajisur me kapacitetet e nevojshme mjedisore jo vetëm për shërbimet që lidhen me procesin e mirëfilltë akademik, por edhe me ato dytësore, të shërbimit studentor. UMSH ka një numër të mjaftueshëm mjedisesh leksionesh, prej 6 amfiteatros (me 100-120 vende të ulura) dhe 15 sallash seminaresh. Infrastruktura është bashkëkohore dhe me lehtësi aksesit edhe për personat me aftësi të kufizuara. Teknologjia e informacionit që zbatohet në universitet përbëhet nga laboratorë të teknologjisë bashkëkohore, dhe laboratorët e gjuhëve të huaja. Gjithashtu referuar RVB-së dhe vizitës në institucion<sup>2</sup>, ekzistojnë 8 zyra për departamentet/qendrat kërkimore dhe dy zyra për personelin akademik. Sa i takon bibliotekës, ekzistojnë hapësira të mjaftueshme dhe komode për zhvillimin e punës shkencore dhe kërkimore të studentëve. Biblioteka ofron edhe shërbimin online me një numër të konsiderueshëm titujsh, ndërsa UMSH është regjistruar në Questia, një ndër databazat akademike më të mëdha në nivel global. Shërbimet e tjera të studentëve përfshijnë personelin administrativ dhe teknik, i pajisur me mjedise të përshtatshme pune, në gjendje të përmbushë detyrimet e shërbimeve ndaj studentëve dhe stafit akademik. Struktura të tjera mbështetëse janë Zyra e Arkivës dhe Protokollit, e cila përmbush detyrimet lidhur me arkivimin e dokumentacionit shkresor dhe online të UMSH-së. Pjesë e infrastrukturës mbështetëse të procesit akademik është

<sup>2</sup> Ky përfundim bazohet në vizitën fizike në këto zyra, gjatë vëzhgimit të infrastrukturës, me koordinatoren e institucionit për këtë proces ri-akreditimi, Prof. Nevila Rama. Këqyrja fizike përputhet me të dhënat e raportuara në RVB (fq. 28-32).



sekretaria mësimore dhe zyra e pranimit, zyra e financës, burimet njerëzore dhe zyra e Këshillit Studentor.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Mjediset për Programin e studimit (Shih në Aneks, Tabela 7).

- Salla për leksione 6
- Klasa për seminare 15
- Salla për aktivitete promovuese 1
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët -
- Laboratorë informatike 3
- Salla interneti 1
- Salla për bibliotekë 4
- Mjedis për fotokopjime, librari etj 1
- Zyrë informacioni për studentët 1
- Nyje hidrosanitare 53

Për një numër të plotë të këtyre mjediseve, shih në *Aneks Tabelën 4.1*. Nga këqyrja në institucion, rezulton një përputhje e plotë midis mjediseve të deklaruara dhe atyre të konstatuara.

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin 7
- Zyra për sekretarinë mësimore 3
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore 8
- Zyra për personelin akademik 1

Për një numër të plotë të këtyre mjediseve, shih në *Aneks Tabelën 4.1*. Nga këqyrja në institucion, rezulton një përputhje e plotë midis mjediseve të deklaruara dhe atyre të konstatuara.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Nga vizita në institucion (*dt. 7 dhe 8 qershor 2018*) rezulton një përputhshmëri e plotë e gjendjes së konstatuar me të dhënat e deklaruara nga Institucioni në RVB. Kështu nga këqyrja fizike e sallave për leksione, atyre për seminare, mjediseve të bibliotekës, zyrës së informacionit, mjediseve të shërbimit, nyje hidrosanitare, etj, ka sasi dhe sipërfaqe të mjaftueshme për kryerjen e procesit mësimor dhe për komoditetin e personelit akademik e atij administrativ/mbështetës.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</b> <b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Në përgjithësi infrastruktura e bibliotekës është e një niveli të kënaqshëm dhe procesi mësimor për studentët e programit Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci lehtësohet nga akseset e tyre në literaturën bazë, e cila ndodhet në bibliotekë. Studentët kanë gjithashtu akses edhe në burime elektronike dhe bibliotekat online, si Questia apo The Economist.</p> <p>Databaza elektronike ndërkohë ishte e gjerë dhe me një numër shumë të madh titujsh, të cilët mund të aksesohen nga studentët edhe online, nga shtëpitë e tyre.</p> <p>Institucioni ka marrë një sërë masash për të nxitur punën e studentëve dhe kuriozitetin e tyre studimor/kërkimor, për të shfrytëzuar më shumë aksesin online, në databazat e sipërpërmendura.</p> <p>Në përgjithësi biblioteka përmbush nevojën e realizimit të projekteve kërkimore-shkencore të studentëve dhe stafit akademik, si dhe për përgatitjen e punimeve finale (punimeve të diplomave) të studentëve, të cilat kanë nevojë për literaturë përtej asaj të ofruar gjatë kurseve. Shërbimi i bibliotekës është i shtrirë në fasha orari të zgjatura dhe të përshtatshme për studentët dhe kërkuesit e tjerë shkencorë pranë institucionit.</p> <p>Ndërkohë që në RVB konstatohet se “Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, et.”, ky përfshin pasurimin e saj të menjëhershëm pas kërkesave të lektorëve për literaturën e lëndëve të tyre.</p>
<b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe analiza e RVB-së, rezultojnë se institucioni ka infrastrukturë të përshtatshme mësimore, në përpjesëtim me numrin e studentëve që ai ka për programin mësimor të Bachelor, Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci. Sallat dhe klasat mësimore janë dy lloje, për leksione dhe për seminare, dhe të pajisura me mjetet e duhura audio-vizuale të teknologjisë së informacionit, në funksion të programit të studimeve në shqyrtim.</p> <p>Për shkak të natyrës së programit, që lidhet me shkencat sociale e konkretisht me fushën studimore të politikës ndërkombëtare, laboratorët e nevojshëm gjykohej se janë ato informatikë, me akses në burime</p>

<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>online informacioni dhe dijeje si dhe të përshtatshëm për projekte të ndryshme studentore (e gjithë paketa Microsoft Office). Këto laboratorë ishin plotësisht të përshtatshëm për përmbushjen e objektivave të programit në studim.</p>
<p><b><u>Konkluzione të GVJ:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Nga shqyrtimi i mjediseve mësimore bazuar në RVB dhe këqyrje në institucion, ato janë plotësisht të përshtatshme nga pikëpamja infrastrukturore dhe ajo informatike (laboratorë kompjuterikë) për zhvillimin e procesit mësimor dhe përmbushjen e objektivave të programit.</li> <li>2. Rekomandohet përditësimi i teksteve në bibliotekë me tekste më bashkëkohore dhe të shtëpive botuese më të rëndësishme për fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare/diplomacisë.</li> </ol> <p><b><u>Standardet përmbushen</u></b></p>	


## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Nga pikëpamja financiare, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë gëzon një status të veçantë juridik, unik në llojin e tij, pasi është projekt i OJF-së me emër “Qendra Mesdheu”, regjistruar me Vendim Nr. 441, 06/07/2007, me objekt shërbimet në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. UMSH monitorohet nga Bordi i Administrimit si struktura më e lartë që siguron menaxhimin financiar dhe administrativ. Nga shqyrtimi i rregullores<sup>3</sup>, RVB-së dhe procedurave të menaxhimit financiar gjatë

<sup>3</sup> Rregullorja organizative e UMSH-së, neni 31.



vizitës në institucion, rezultoi se kontrolli dhe auditimi i brendshëm kryhet nga njëسيا e auditimit të brendshëm që emërohet nga autoriteti më i lartë menaxhues i institucionit (Bordi i Administrimit). Garantimi i implementimit të strategjisë financiare të institucionit bëhet i mundur nga zyra e Financës, që ndjek zbatimin e procedurave financiare për realizimin e të ardhurave, kryerjen e investimeve, shpenzimeve, pagesave, mbajtjen e dokumentacionit kontabël dhe hartimin e pasqyrave financiare vjetore, sipas standardeve kombëtare të kontabilitetit, bazuar në Nenin 31 të Rregullores së institucionit.

Situata financiare e institucionit i është nënshtruar auditeve edhe nga ekspertë të huaj, si shoqëria Croëe Horëath Al shpk. Ajo i plotëson kriteret dhe standardet për qëndrueshmërinë financiare afatshkurtër dhe afatmesme, në përputhje me kriteret ligjore të cilësisë.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit
- Sponsorizimet
- Shërbimet trajnuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)

Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion (*takimi dt. 7 qershor 2018 me Prof. Nikolin Pano, në cilësinë e drejtuesit të Strukturës për Punën Kërkimore dhe Shkencore*) rezultoi se të ardhurat nga grantet për kërkime dhe kontrata kanë qenë 0 (zero) gjatë periudhës 2012-2016 (*periudha e përfshirë në raportim në tabelën 8 RVB, fq. 34*), ndërsa të vetmet të ardhura janë mundësuar gjatë vitit 2017, në vlerën 1.599.000 lekë. Kjo është një vlerë shumë e vogël (nën 1%) në raport me totalin e të ardhurave të institucionit.

Zëri kryesor i të ardhurave është nga tarifat për dhe gjatë shkollimit, të cilat kanë shënuar një rritje konstante nga viti në vit (që prej vitit 2012 kur janë vënë në dispozicion të dhënat – RVB, fq. 34, Tabela 8), deri në 2017, kur këto të ardhura ishin 293.645.000 lekë. Ndërkohë që një përqindje shumë e vogël të ardhurash (nën 1%) lidhet me aktivitetet tregtare.

Vihet re se të ardhurat nga konsulencat, shërbimet dhe shërbimet trajnuese janë 0 (zero), çka mund të përbëjë një mundësi për të gjeneruar të ardhura si fryt i punës kërkimore shkencore që mund të realizohet në këtë program për llogari të të tretëve. Ky është një potencial i pashfrytëzuar që në të ardhmen mund të kthehet në gjenerues të ardhurash për institucionin.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Bazuar në raportimin financiar të vitit akademik kostoja financiare për student, për vitin akademik 2014-2015 ishte 102.000 lekë (mbi një total të financimit prej 162.819.000 lekë); për vitin akademik 2015-2016 kostoja për student ishte 106.000 lekë (mbi një total të financimit 215.443.000 lekë); për vitin akademik 106.000 lekë (për një total të financimit prej 254.137.000 lekë); kurse për vitin 2017-2018 kostoja për student është 137.000 lekë (për një total financimi prej 288.522) (Shih Tabelën 8.2 në *Aneks*). Gjatë periudhës së sipërpërmendur vihet re se ndërsa ka një rritje konstante të financimit në nivel institucioni, kostoja për student ka qenë relativisht konstante.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Bazuar në të dhënat e Dosjes së Vetëvlerësimit (fq. 32-34) (Shih në *Aneks*, Tabela 8) të vëna në dispozicion nga Institucioni, rezultojnë se të ardhurat financiare janë të kënaqshme dhe se ato janë rritur në mënyrë konstante gjatë viteve të fundit dhe konkretisht gjatë periudhës 2012-2017, nga 93.332.000 lekë (2012) në 298.606.000 lekë (2017). Kjo tregon se institucioni ka një qëndrueshmëri financiare ndër vite, e cila e bën të përballojë me sukses objektivat akademike. Gjithashtu këto burime bazohen në masën mbi 99% tek të ardhurat nga tarifat e shkollimit, ndërsa nuk ka të ardhura nga grantet për kërkime, nga fonde jopublike ose publike, apo nga burime të tjera. Nga vizita në institucion rezultoi se këto të dhëna përputhen me evidencat dhe treguesit në terren. Kontrolli financiar dhe audit i brendshëm e i jashtëm financiar menaxhohen në përputhje me standardet dhe kriteret ligjore kombëtare.

#### Vlerësimi sipas Standardeve


Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;	UMSH përmbush plotësisht kriteret e auditit të situatës financiare për përdorimin e buxhetit të ciklit të dytë, konkretisht të programit Bachelor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Diplomaci, në funksion të rritjes së cilësisë së studimit dhe forcimit të cilësisë e kapaciteteve të stafit akademik. Auditimi është i përvitshëm dhe adreson plotësimin e kërkesave ligjore dhe miratimin e pasqyrave financiare. Gjithashtu auditimi shprehet çdo vit dhe mbi situatën financiare të Qendrës Mesdheu. Në pasqyrat e vendosura në dispozicion rezultojnë se të ardhurat nga grantet, konsulenca dhe shërbimet për të tretë zënë një vend shumë të vogël të burimeve financiare
<b>Kriteri 2</b> Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;	
<b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.	

	<p>të programit, ndërsa mbi 99% e të ardhurave bazohet tek tarifat e shkollimit.</p> <p>Bordi i Administrimit, si autoriteti më i lartë i menaxhimit financiar, kërkon dhe merr në shqyrtim raportet e realizimit të buxheteve në funksion të rritjes së cilësisë së programeve dhe studimeve, përmirësimit të stafit akademik.</p>
<b>VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR</b>	
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë tëhollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Bazuar në evidencat e paraqitura në RVB (fq. 33-36) dhe nga konstatimet e vizitës në Institucion, këto kriteret konsiderohen të përmbushura. Në raportet financiare të shqyrtuara rezultoi se Institucioni ka krijuar të ardhura të qëndrueshme gjatë periudhës kohore 2012-2018, ka kryer investime në infrastrukturën e mësimdhënies, në hapësirat dhe mjediset ku zhvillohet puna akademike e shkencore, por edhe e ka pajisur atë me sisteme bashkëkohore elektronike. Të gjitha këto janë pasqyruar në raportet financiare. Qëndrueshmëria financiare bazohet në rritjen konstante të të ardhurave.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p>	
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Institucioni përmbush plotësisht kriteret e auditit të situatës financiare për përdorimin e buxhetit të ciklit të dytë në funksion të rritjes së cilësisë së studimit dhe forcimit të cilësisë e kapaciteteve të stafit akademik.</li> <li>2. Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit të Masterit Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare.</li> </ol>	
<p><b><u>Standardet përmbushen</u></b></p>	

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njesisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.



Institucioni ka ngritur një sistem të brendshëm të sigurimit të cilësisë që ka si objektiv garantimin e përputhshmërisë së veprimtarisë mësimore, akademike, shkencore dhe administrative me kuadrin ligjor në fuqi, statutin dhe aktet e tjera institucionale. Për këtë UMSH rezulton se ka ngritur një strukturë të përhershme që ka integruar cilësinë dhe kurrikulat, të quajtur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK). Nga takimet e realizuara me këtë njësi na u tha që ajo ishte ristrukturuar në Nëntor të vitit akademik 2017 -2018. Njësia kryen kontrollon dhe vlerësime të rregullta mbi të gjitha veprimtaritë akademike, kërkimore, rishikim e sylabuseve nga ana formale, etj. Funksionimi i saj rregullohet nga një sërë dokumentesh dhe urdhërash, si Manuali i Sigurimit të Brendshëm, të cilat kjo njësi i kishtë hartuar dhe përditësuar që prej riorganizimit të saj. NJSBCZHK këtë vit akademik kishtë ristrukturuar edhe pyetësorin e studentvë duke e bërë atë më të thjeshtë për studentët.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
- Sa anketime kanë bërë me studentët
  - Sa studentë janë anketuar
  - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
  - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
  - Etj

NJSBCZHK kryen çdo vit anketime me studentët. Këto anketime kryhen në përfundim të çdo semestri akademik, nëpërmjet pyetësorëve që u shpërndahen studentëve përpara se ata të zhvillojnë provimet e lëndëve përkatëse. Pjesëmarrja e studentëve në këto anketime është 60% e numrit të tyre në çdo vit akademik.

Në vijim të procesit të anketimeve, Njësia përpunon rezultatet vetëm nga 25% e anketimeve të zgjedhura në mënyrë rastësore. Rezultatet e anketimit raportohen pranë fakulteteve dhe në nivel rektorati, shoqëruar me arsyetimin e tyre dhe me sugjerimet për ndryshime të mundshme. Nga analiza e RVB-së (fq. 37-43) dhe takimi në institucion me NJSBCZH (Znj. Nevila Xhindi, drejtuese e njësisë), rezulton se ka pasur disa raste kur institucionit i janë dhënë rekomandime konkrete për punën e pedagogëve dhe tematika lidhur me mësimdhënien, të cilat janë adresuar në vijim prej tyre, për të përmirësuar procesin. Në disa raste ka pasur edhe marrje masash ndaj pedagogëve.<sup>4</sup> Kjo u konstatua edhe nga takimi me studentët, të cilët u shprehën në përgjithësi se mendimet e tyre janë marrë në konsideratë.

---

<sup>4</sup> Ky konstatim bazohet në takimin me Dekanin dhe Përgjegjës të Departamentit, si dhe me Zyrën e Burimeve Njerëzore.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Funksionimi i njësisë rregullohet nëpërmjet një agjende në nivelin e vitit akademik, ku renditen prioritetet vjetore, forma e kontrollit, sektorët dhe proceset të cilat do të bëhen objekt kontrolli. Njësia ka gjithashtu detyrim kryesor llogaridhënien për gjetjet dhe vlerësimet e saj në Rektorat, në fakuletet dhe me stafin e UMSH-së. Bazuar në raportin e RVB-së dhe në takimet e zhvilluara në institucion<sup>5</sup>, procesi i raportimit të gjetjeve tek pjesëtarët e stafit akademik dhe administrativ është sekretiv dhe në respekt të konfidencialitetit. Objektivi është marrja e masave për adresimin e problematikave të ngritura, në funksion të rritjes së performancës së personelit akademik dhe administrativ, si dhe përmirësimit të cilësisë së institucionit në tërësi.

Njësia i kushton vëmendje trajnimit periodik të stafit akademik dhe atij administrativ, që kryhet kryesisht në fillim të vitit akademik. Gjithashtu trajnimet zhvillohen edhe në grupe më të vogla, me stafin e pedagogëve të jashtëm, për të shpjeguar proceset administrative, detyrimet, rregulloren e institucionit, organizimin e proceseve të mësimdhënies, etj.<sup>6</sup>

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti (Shih Tabela 10 në Aneks)

NJSBCZHK kryen monitorime periodike jo vetëm të procesit të mësimdhënies në nivelin e stafit akademik individual, por edhe të veprimtarisë kërkimore-shkencore në nivel departamenti. Gjetjet e këtyre vlerësimeve/monitorimeve diskutohen në mënyrë intensive midis anëtarëve të njësisë dhe përfaqësuesve të departamenteve, në funksion të përmirësimit të cilësisë së departamentit. Nga vizita në institucion<sup>7</sup> dhe RVB, rezultojnë se ky proces shoqërohet me një plan masash konkrete, në formën e angazhimeve dhe të detyrave që merr përsipër çdo njësi departamentale gjatë periudhës në vijim.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre.

Puna e Njësisë bazohet kryesisht në anketimin e studentëve lidhur me lëndët dhe institucionin në përgjithësi. Në raste të konstatimeve të problematikave të theksuara, ato shoqërohen me marrje masash ndaj pedagogëve. Raste të tilla janë përmendur edhe gjatë vizitës në institucion nga stafi akademik por edhe studentët e programit Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, e lidhen kryesisht me literaturën e rekomanduar, mënyrën e zhvillimit të mësimin, cilësinë, provimet, etj. Këto raste janë adresuar nga strukturat përgjegjëse, në formën e këshillimit për përmirësimin e mësimdhënies dhe metodologjisë së përdorur gjatë leksioneve/seminareve.

<sup>5</sup> Ka një përputhshmëri midis RVB-së dhe takimit me stafin akademik të departamentit.

<sup>6</sup> Kjo u vërtetua nga takimi me drejtuesen e Njësisë, Prof. Asoc. Dr. Nevila Xhindi.

<sup>7</sup> Takimi me drejtuesen e Njësisë, Prof. Asoc. Dr. Nevila Xhindi.





Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Në themel të politikave të përmirësimit të cilësisë të UMSH-së qëndron angazhimi i marrë si produkt i raportit vjetor të vetëvlerësimit, të hartuar dhe miratuar nga NJSBCZHK. Çdo njësi merr detyrat përkatëse dhe harton një plan-veprimi për të adresuar komentet/sugjerimet/udhëzimet e raportit. Rezulton se plan-veprime të tilla në formë të shkruar dhe të miratuar nuk ekzistojnë ose janë ende në proces hartimi.

Dosja e vetëvlerësimit përmban informacion të qartë dhe të plotë mbi procesin e ngritjes dhe funksionimit të Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave. Ajo shpjegon në mënyrë të detajuar institucionalizimin e kësaj strukture dhe rolin e saj në garantimin e cilësisë akademike dhe infrastrukture. Në dosje pasqyrohet në mënyrë të plotë roli dhe përfshirja e studentëve në procesin e vlerësimit të pedagogëve dhe institucionit, si dhe nga bashkëbisedimi me studentët u ofruan shpjegime/raste të marrjes parasysh të vërejtjeve të tyre nga pedagogët dhe/ose institucioni. Përveç kësaj, nga këqyrja në institucion e praktikave të funksionimit të NJSBCZHK-së rezulton se njësia ka një rol të rëndësishëm në procesin e garantimit të cilësisë së institucionit.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b> <b>Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve; <b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional; <b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë; <b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:	Kriteret që zbaton institucioni për të vlerësuar cilësinë e brendshme burojnë nga Statuti i tij, nga Manuali i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (miratuar nga Senati Akademik), nga Ligji për Arsimin e Lartë (Nr. 80/2015) dhe nga dokumentacioni i ASCAL-it. Institucioni përdor një tërësi mekanizmesh për të vlerësuar dhe siguruar cilësinë e brendshme, përfshirë kontrollet brenda-institucionale, anketimet me studentët, grupet e monitorimit në
Të tërthorta: a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; c. Pyetje konceptuale; d. Intervista; e. Etj.  Të drejtpërdrejta:	nivel departamenti dhe përditësimin e publikimin e rezultateve të procesit. NJSBCZHK ka pika kontakti në çdo departament, të cilët janë pedagogë që luajnë rol koordinues dhe facilitues të procesit të vlerësimit të brendshëm Sugjerohet në këtë pikë që mekanizmi i kontrollit të cilësisë të shtrihet dhe në nivel silabusesh, jo përmbajtësor por formal, për të garantuar respektimin e standardeve të

<p>a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Vlerësimi me nota/pikë;</p> <p>d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</p> <p>e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Etj.</p>	<p>vendosura nga vetë institucioni.</p> <p>Institucioni kryen në mënyrë periodike vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe shkencore të vetë pedagogëve, si dhe nëpërmjet anketimeve me studentët, duke i reflektuar në vlerësimin e performancës së pedagogut në fund të vitit akademik. Nga vizita në institucion rezultoi se ky ishte vetëm një prej aspekteve të vlerësimit të punës së pedagogëve.</p> <p>Gjithashtu të dhëna të tjera që përpunohen dhe kryqëzohen nga NJSBCZHK janë intervistat gjysëm të strukturuar me studentët, kalueshmëria për lëndë e pedagogëve, etj.</p> <p>Metodat e vlerësimit janë të drejtpërdrejta dhe të tërthorta:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Anketimet e studentëve për programet, pedagogjinë, etj</li> <li>- Intervista gjysëm të strukturuar</li> <li>- Një metodë më e drejtpërdrejtë është dëgjesa në auditor nga Dekani dhe/ose Përgjegjësi i Departamentit.</li> <li>- Vlerësimi me pikë dhe analiza e mënyrës së vlerësimit të Detyrave të Kursit.</li> </ul>
<p><b>VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË</b></p> <p><b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të</p>	<p>Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar e ri-akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve, pasi programet për të cilat po kryhet procesi i akreditimit periodik janë akredituar në vitin 2012.</p> <p>Institucioni përdor mjetet e duhura për sigurimin e cilësisë sepse ai përfshin në proces një numër aktorësh të rëndësishëm, si studentët, NJSBCZHK-në, departamentet, dekanatin, etj. Përfshirja në proces është thelbësore, ndonëse sugjerohet përmirësimi i standardizimit të silabuseve dhe kontrollit formal të tyre si dhe mekanizma shtesë të vjeljes së gjykimit të studentëve nëpërmjet fokus-grupeve, apo kontrolli (rastësor) mbi vlerësimin e tezave. Raportimet që nxjerr institucioni janë të vlefshme për kontrollin e nivelit të cilësisë së tij të brendshme dhe periodicitetin i tyre i vendos në kushtet e ndërtimit dhe monitorimit të plan-veprimeve për adresimin e problematikave të mundshme të shfaqura.</p>

cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.	Institucioni gjithashtu e ka pjesë të strategjisë së tij të zhvillimit fuqizimin e mëtejshëm të NJSBCZHK-së.
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Institucioni përdor mjetet e duhura për sigurimin e cilësisë sepse ai përfshin në proces një numër aktorësh të rëndësishëm, si studentët, KSBCZHK-në, departamentet, dekanatin.</li> <li>2. Puna e KSBCZHK-së mund të shtrihet në të ardhmen edhe në procesin e kontrollit të silabuseve të lëndëve, nga pikëpamja e përbushjes së kriterëve të tyre formale. Kjo do të garantonte një formë më të plotë të kontrollit të dyfishtë të tyre, nga Departamenti dhe Njësia.</li> <li>3. Sugjerohet zhvillimi edhe i fokus-grupeve me studentët, për të forcuar kuptueshmërinë e cilësisë së institucionit, përtej anketimeve me studentët dhe intervistave me ta.</li> <li>4. Sugjerohet gjithashtu këqyrja rastësore e mënyrës së korrigjimit të tezave nga pedagogët, kryesisht për të identifikuar raste të ndryshimeve të pajustificuara të notave, në funksion të forcimit të cilësisë.</li> <li>5. Duhet standardizuar formatet, sidomos ato që përfshijnë elementë cilësorë.</li> <li>6. Një sugjerim tjetër lidhet me standardizimin e performancës së kërkimit shkencor të stafit akademik.</li> </ol> <p><b><u>Standardet përbushen</u></b></p>	


## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

### 7. Programi i studimit, organizimi i tij

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Misioni dhe objektivi kryesor i programit të ciklit të parë Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci është t'i pajisë studentët me njohuritë e nevojshme për specializimin e tyre në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë. Ky program studimi ka si qëllim krijimin e mundësive që studentët të mund të vazhdojnë studime më të thelluara në të ardhmen në fushën marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë.



Nëpërmjet këtij programi studimi studentët pajisen me një formim i shumëanshëm duke u bazuar në disa prej lëndëve kryesore të cilat zhvillohen si psh: Teoria e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Historia e Diplomacisë, E Drejta Ndërkombëtare, Studime Evropiane, Analiza e Politikës së Jashtme. Ky program i mundëson studentëve studentëve të orientohen drejtë në tregun e punës .

Pas përfundimit të këtij programi studimi, në sajë të njohurive të marra, studenti aftësohet për mundësinë e punësimit në sektorin publik dhe në atë privat,

Sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program studimi do t'ju krijojnë atyre mundësinë edhe për ndjekjen e një karriere kërkimore apo akademike nëpërmjet vazhdimit të studimeve të masterit shkencor, ose të studimeve të një masteri profesional, jo vetëm në fusha shkencore të përafërta me marrëdhëniet ndërkombëtare dhe diplomacinë

Kurikulat janë pjesë thelbësore e këtij programi studimi duke u përpjekur për ta bërë atë sa më bashkëkohor dhe të vlefshëm në aspektin praktik për studentët. Programi i studimit shoqërohet me botime, literaturë bazë dhe ndihmëse e cila gjëndet në bibliotekën e UMSH duke nxitur më tej edhe kërkimin shkencor në këtë disiplinë si për studentët ashtu edhe për pedagogët.

Rëndësi e vecantë i kushtohet informimit në mënyrë të vazhdueshme të studentëve mbi programet e studimit, kohëzgjatjen e tyre, kreditet, lëndët.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Me urdhrin Nr.273 datë 18.05.2017 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, mbi bazën e kërkesës së SHLP Mesdhetare e Shqipërisë, është miratuar hapja e njësisë kryesore “Fakulteti i Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike” dhe riorganizimin e njësisë kryesore nga Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike në “Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare” të Shkollës së Lartë Private “Mesdhetare e Shqipërisë”.

Referuar RVB Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci filloi të ofrohet për herë të parë në UMSH në vitin akademik 2009-2010.

Misioni dhe objektivi kryesor i programit të ciklit të parë Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci është t'i pajisë studentët me njohuritë e nevojshme për specializimin e tyre në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë si dhe ti bëjë sa më të aftë për tregun vëndas dhe të huaj .

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore = 60'

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

<input type="checkbox"/> Leksionet	12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit
<input type="checkbox"/> Seminaret/Ushtrime	11 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit
<input type="checkbox"/> Seminaret/Detyra	10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
<input type="checkbox"/> Praktikë Profesionale	21 orë në auditor dhe 4 orë punë e pavarur e studentit
<input type="checkbox"/> Provim Përfundimtar	1 orë në auditor dhe 24 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Plotësoni Tabelën ne Aneks)

Nuk ka patur ndryshime në planet mësimore.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Shih Tabelën përkatëse në Aneks)

Planet mësimore dhe lëndët përputhen me formimin akademik dhe profesional të pedagogëve.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën

- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse


Analizë e cilësisë së syllabuseve

Në përgjithësi silabuset ishin të qartë dhe të kuptueshëm nga studentët. Në to pasqyroheshin objektivat e lëndës, qëllimet e saj si dhe mënyrën e vlerësimit me notë nga profesori i lëndës. Në to ishte e pasqyruar edhe literatura bazë për lëndën dhe ajo ndihmëse. Syllabuset në përgjithësi kishin të njëjtën metodë të ndjekur për vlerësimin që e bën më të lehtë për studentët orientimin dhe angazhimin e tyre maksimal për të arritur qëllimet mbi lëndën. Në syllabus parashikohen dhe metoda të ndryshme të gërshetuara të mësimdhënies si diskutimet, simulimet, punë individuale apo në grup.

Rekomandojmë që në syllabus të specifikohen edhe leximet që duhet të realizojë studenti për temën e leksioni apo seminarit.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA</b>	
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas ECTS dhe i nënshtrohet riakreditimit.</p> <p>Studenti i cili ndjek programin e studimit Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci me kohë të plotë i duhet të grumbullojë gjatë një viti 60 kredite.</p>
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një</p>	<p>Referuar RVB, strategjisë si dhe rregullores së brendshme të programit të studimit, studentëve i jepet një informacion i detajuar për programin, për kohëzgjatjen, ngarkesën si numër lëndësh dhe pedagogët që e zhvillojnë atë, për kurrikulën, frekuentimin, metodologjinë e mësimdhënies, literaturën dhe formën e vlerësimit. Studentët mund të informohen nëpërmjet sekretarisë, pedagogut përgjegjës të lëndës por dhe online në lidhje me ndryshimet e mundshme në programin e studimit.</p> <p>Një informacion më i detajuar mbi programin e studimit jepet vecanërisht në fillimin e vitit akademik</p> <p>Në javën e parë të studimeve organizohet “Java e Informimit” ku specifikisht e gjithë java organizohet si javë orientuese për studentët e rinj.</p>



<p>program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Çdo pedagog sipas lëndës së tij specifike informon me gojë dhe gjithashtu me email për detyrimet specifike secilin student. Çdo student i vihet në dispozicion një email zyrtar me prapashitesën <a href="mailto:umsh.edu.al">umsh.edu.al</a>.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Në përgjithësi programi i përmbush kërkësat ligjore (numrin e krediteve, ruajtjen e vlerave, aftësimin profesional dhe përputhshmëria me strategjinë e institucionit) bazuar në dokumentacionin e ofruar, RVB si dhe në verifikimet gjatë vizitës në institucion.</li> <li>2. Informacioni që ju vihet në dispozicion studentëve në lidhje me programin e studimit si nga ana e sekretarisë, faqes së UMSH, pedagogëve është plotësisht e nevojshme dhe plotëson standartin e kërkuar.</li> <li>3. Propozohet: që përsa i përket syllabuseve të lëndëve duhet të jenë më specifike përsa i përket literaturës së përdorur dhe leximeve për cdo leksion dhe seminar.</li> <li>4. Për të rritur efikasitetin e këtij programi studimi propozohet: që duhet të ketë një studim më të mirë të tregut të punës në mënyrë që programi të dimensionohet në përputhje me këto kërkesa.</li> </ol> <p><b><u>Standardet përmbushen krvesisht.</u></b></p>	

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore


**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia në programin Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci bazohet në një kurrikulë të veçantë, e cila gjithsesi huazon dhe lëndë nga departamente të tjera të fakultetit. Mësimdhënia me këtë kurrikulë është miratuar që në hapjen e tij dhe organizohet në formën e leksioneve dhe seimareve, ndërsa plotësohet forma të tjera më praktike, si praktikat profesionale dhe orët e konsultimit akademik. Gjatë vitit të parë të studimeve, studentët marrin njohuri të përgjithshme mbi shkencat politike dhe juridike në përgjithësi, të ndërthurura me dije rreth historisë dhe institucioneve të Bashkimit Evropian. Viti i parë zhvillohet i përbashkët me programin Bachelor të Shkencave Politike. Në vitin e dytë dhe të tretë ata specializohen më tej në lëndët e profilit të tyre të Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Ngarkesa në auditor realizohet në formën e leksioneve dhe seminareve në përputhje me kualifikimet e pedagogëve. Nuk konstatohen papërputhshmëri midis specialitetit akademik të pedagogëve dhe lëndëve ku ata figurojnë si titullarë. Metodatat e mësimdhënies janë bashkëkohore, të bazuara në interaktiviteti dhe teknologji bashkëkohore, studentët aktivizohen në seminare dhe në leksione. Gjithashtu ka shpërndarje të ngarkesës së lëndëve të tyre nëpër semestra. Për lëndët me karakter më praktik/aplikativ, vërehet se pesha bie më shumë në metoda më aplikative të mësimdhënies, të pasuruara me raste studimore. Bazuar në RVB dhe në takimet e zhvilluara në institucion, metoda e mësimdhënies konstatohet se është interaktive. Kjo përputhet me natyrën e nivelit Bachelor, që nxit të mësuarit kritik, duke i bërë studentët pjesë të analizës dhe interpretimit të fenomeneve të marrëdhënies ndërkombëtare. Interaktiviteti realizohet nëpërmjet rasteve studimore, ndarjes së punës në grup, prezantimeve të çështjeve specifike, etj. Metoda të tjera të mësimdhënies përfshijnë simulime rastesh, ndarje në grup dhe “brainstorming”, interpretim analitik, prezantime, hulumtime të orientuara që referohen më pas në klasë, etj. Nga pikëpamja teknologjike vërehet përdorimi i prezantimeve dhe i shfaqjes së materialeve audiovizuale që i ndihmojnë studentët të familjarizohen me subjektin e analizës.

Konstatohet se studentët përfshihen në aktivitete shkencore, si Panairi i Ideve, apo edhe veprimtari të tjera shkencore brenda departamentit (konferenca, simpoziume) me punime të tyre, ndonëse kjo në masë të kufizuar, për shkak edhe të nivelit të diplomës (Bachelor). Megjithatë kjo është intensifikuar gjatë dy viteve të fundit akademikë. Gjatë semestrit të dytë të çdo viti Departamenti i Marrëdhënies Ndërkombëtare organizon në kuadrin e këtij programi Bachelor “Role Play: United Nations Security Council”. Një organizim gjatë të cilit studentët ndahen në grupe dhe mbrojnë interesat e vendeve-anëtare të Këshillit të Sigurisë bazuar në një axhendë paraprake diskutimesh. Ndërkohë, Departamenti, në bashkëpunim me atë të Shkencave Politike, realizon çdo vit një iniciativë të quajtur “Kinemaja Politike” në 10 javë. Një iniciativë e ndërmarrë në vitin 2018 ka qenë ajo e themelimit të Shoqatës së Studentëve të fakultetit të shkencave juridike dhe marrëdhënies ndërkombëtare në nivel kombëtar. Kjo iniciativë synon përfshirjen e studentëve në aktivitete shkencore kombëtare.

Studentët konstatohet se kanë mundësi të vlerësojnë mësimdhënien nëpërmjet vlerësimit të çdo lënde. Forma të tjera vlerësimi të brendshëm përfshijnë “vizitat në auditor” nga përgjegjësi i Departamentit të Marrëdhënies Ndërkombëtare dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare, të pasuara nga vërejtje, sugjerime dhe analiza për pedagogë dhe lëndë të caktuara.





**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Shih Tabelën 14 të Planit në Aneks):


<b>Programi i Studimit Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci</b>	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	960
Seminare	765
Ushtrime	30
Laboratore	
Praktikë lëndore	
Praktikë profesionale	120
Provimi përfundimtar/Diploma	20
Në total	1895

Duhet theksuar se për këtë program Bachelor-i, institucioni ka vendosur të mos ketë punim diplome, por të bazohet në një provim përfundimtar, i cili teston njohuritë e studentëve në një numër fushash të konsideruara të rëndësishme të marrëdhënieve ndërkombëtare. Provimi përfundimtar bazohet në një listë pyetjesh.

Ndërsa praktikat e studentëve zhvillohen në disa institucione, si Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, etj.

- Format e kontrollit të njohurive (Tabela 15 në Aneks)

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	Në varësi të lëndës, specifikave të saj dhe metodologjisë së përdorur, ose vendosen detyrime laboratorike, detyra kursi, prezantime etj ose testime mes-semesterale në nivelin 20%.



Testimet gjatë vitit	Në varësi të lëndës, specifike të saj dhe metodologjisë së përdorur, ose vendosen detyrime laboratorike, detyra kursi, prezantime etj ose teste mes-semestrale në nivelin <b>20%</b> .
Provimi përfundimtar	<b>70%</b>
Etj	
Në total	<b>100%</b>


Nga konstatimi gjatë vizitës rezultojnë se kjo nuk është forma e vetme e vlerësimit të lëndëve, pasi disa lëndë kanë vlerësim më të madh të testeve të ndërmjetme. Ndërsa për detyrat e kursit, pavarësisht se studentët rezultojnë të paralajmëruar nga pedagogët e lëndëve përkatëse lidhur me pasojat akademike në rastin e plagjiaturës, nuk ekziston një sistem/iniciativë anti-plagjiature, i cili të jetë i ndërtuar në bazë universiteti.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Konstatohet se përfshirja e studentëve të programit Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe diplomaci në aktivitetin shkencor të institucionit realizohet vetëm për projekte shkencore në rang fakulteti (me 46 angazhime të tilla), ndërsa studentët nuk rezultojnë të përfshirë në punën shkencore individuale të pedagogëve, në projekte shkencore në nivel departamenti apo në projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë. Megjithatë studentët konstatohet se janë përfshirë në Panairin e Ideve që mbahet çdo vit në formën e një konference studentore me ide shkencore.

Në këto kushte sugjerohet përfshirja më aktive e studentëve në punimet shkencore të pedagogëve dhe departamentit. Një sugjerim tjetër lidhet me ndërtimin e një sistemi të brendshëm anti-plagjiaturë, ndryshimin sistematik (çdo vit) të temave të eseve që u jepen studentëve dhe mënjanimin e temave të lira të eseve (për sa kohë kjo nuk çënon lirinë akademike dhe kërkimore të studentëve).

Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Për punime shkencore individuale të pedagogëve	n/a
Për projekte shkencore në rang Departamenti	n/a
Për projekte shkencore në rang Fakulteti	46
Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë	n/a



- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Nga verifikimi i dosjes së vetëvlerësimit dhe gjendjes së konstatuar në institucion, vërehet se ekziston përputhshmëri me shumicën e dokumentacionit të paraqitur lidhur me treguesit e matshëm të mësimdhënies, format e kontrollit të njohurive dhe aktivizimit të studentëve në punën shkencore të departamentit.

## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Kriteret e pranimit në ciklin e parë të studimeve janë në përputhje me ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH”, Statutin, Rregulloren Organizative të Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë dhe Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Shkenca Politike.

Për t’u pranuar në një program studimi të ciklit të parë kandidati duhet të plotësojë disa kushte. Fillimisht studentit duhet të vërtetojë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë vendit si dhe të plotësojë kriteret e përcaktuara sipas akteve nënligjore në fuqi dhe kriterëve të veçanta të përcaktuara nga institucioni.

Komisioni për përzgjedhjen e kandidatëve përcaktohet nga Dekani i Fakultetit. Njësia bazë dhe ajo kryesore përcakton kriteret e përzgjedhjes të cilat më pas miratohen nga Senati Akademik.

Fakulteti përpunon numrin e të dhënave përsa i përket studentëve të cilët ndjekin programin e studimit Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci si dhe numrit të studentëve në dalje ndër vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve apo problematika në lidhje me to.

---

Sistemi i informimit të studentëve mbetet i rëndësishëm dhe i kushtohet rëndësi e veçantë për tu realizuar vecanërisht nëpërmjet broshurave të ndryshme dhe sekretarisë.

Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit bëhen publik në faqen zyrtare të UMSH, në broshurën informuese dhe gjatë fushatës së marketingut.

Procesi i informimit të studentëve koordinohet nga Sekretaria Mësimore dhe Pranimet në bashkëpunim me ZKKS. Në aktivitetet kryesore të këtij procesi përfshihen:

- Këshillimi pedagogë-aplikantë në ambjentet e UMSH gjatë fazës së regjistrimeve.



- Fushata mediatike – kombinon reklamat televizive dhe ato në median e shkruar, daljet e përfaqësuesve/ pedagogëve në emisione televizive, dhe përdorimin e rrjeteve sociale.

Në ciklin e parë të studimeve mësimdhënia realizohet nga lektorë me grada shkencore sipas kërkesave ligjore. Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në ciklin e parë të studimeve përzgjidhet bazuar edhe në eksperiencën e punës.

#### Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Për t'u pranuar në një program studimi të ciklit të parë kandidati duhet të plotësojë këto dy kushte kushte kryesore ligjore por edhe kritere të vendosura nga institucioni:

1. Studenti duhet të vërtetojë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë vendit (ekuivalentuar sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për arsimin);
2. Studenti duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara sipas akteve nënligjore në fuqi dhe kritereve të veçanta të përcaktuara nga institucioni.


Gjithashtu përsa i përket përzgjedhjes ajo bëhet nga një komision i caktuar nga Dekani, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur si dhe nga shqyrtimi i dosjes personale të kandidatit.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Nota mesatare më e ulët për pranimin në hyrje të studentëve prej vitit akademik 2011-2012 deri në vitin akademik 2017-2018 është 6.4. Mesatarja më e lartë e pranimit i përket vitit akademik 2011-2012 dhe është 8.89. Në shqyrtimin rastësor të tre dosjeve studentësh gjatë vizitës vlerësuese në institucion u konstatua se është ruajtur në nivele normale cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare (Shih Tabelën përkatëse në Aneks).

Studentë të regjistruar për herë të parë në vitin e parë prej vitit akademik 2011-2012 deri në vitin akademik 2017-2018, sipas RVB të UMSH janë gjithsej 189. Notat mesatare variojnë nga viti në vit por një mesatare e përgjithshme e të gjithë viteve akademike e notës hyrëse të studentëve është 7.5.



Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare  
Referuar dokumentave shtesë të kërkuara dhe të vëna në dispozicion gjatë vizitës 2 ditore në institucion rezulton se numri i studentëve të diplomuar në vitin akademik 2016-2017 është 25.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Studentët kanë mundësi për tu përfshirë në projekte të ndryshme brenda institucionit si dhe të financohen prej tij për pjesëmarrjen në kualifikime të mëtejshme.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka pranuar dhe pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera të larta, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të saj në shkolla të tjera të larta, sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e UMSH si dhe bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr 80/2018 datë 22.07.2015, në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës dhe në frymën e Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr 37, datë 29.10.2008 “Për transferim studimesh në ciklin e parë me kohë të plotë në Vitin Akademik 2008 – 2009”.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Nuk ekziston një bazë të dhënash me të dhëna për punësimin e të gjithë studentëve pas diplomimit të tyre.

Numri total të diplomuarve

Numri total i të diplomuarve prej vitit akademik 2012-2013 deri në vitin akademik 2016-2017 sipas dokumentacionit shtesë të vënë në dispozicion nga institucioni është 95.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Referuar RVB, numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën është 30.


Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Referuar RVB, numri total i të punësuarve jo në përputhje me diplomën është 25.

#### **Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</b>	
<b>Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.</b>	
<b>Kriteri I</b> Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e	Kriteret e pranimit në ciklin e parë të studimeve është në përputhje me ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin

<p>Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>shkencor në RSH”, Statutin, Rregulloren Organizative të Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë” dhe Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci.</p> <p>Pranimi në ciklin e parë të studimeve është i lidhur dhe me plotësimin e kritereve të përcaktuara sipas akteve nënligjore në fuqi dhe kritereve të veçanta të përcaktuara nga institucioni. Referuar nenit 50 të Rregullosë Organizative janë përcaktuar modalitete në lidhje me propozimin e kritereve të veçanta për përzgjedhjen e studentëve në këtë program.</p> <p>Kuotat e studentëve që mund të regjistrohen në secilin program të studimeve dhe kriteret e përzgjedhjes propozohen nga njësitë bazë dhe kryesore sipas akteve ligjore dhe administrative të Institucionit dhe miratohen nga Senati Akademik.</p>
<b>Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” ofron informim të vazhdueshëm dhe gjithë asistencën e nevojshme, në mënyrë që të për dhënien e informacioneve për programin e studimit. Secili prej pedagogëve, e ka si detyrë kontraktuale, dhënien e ndihmës dhe informimin e çdo studenti. Në momentin e regjistrimit të studentëve atyre u mundësohet hapja e emailit zyrtar që të realizohet sa më mirë shkëmbimi i informacioneve ndërmjet tyre dhe stafit akademik dhe administrative.</p> <p>Anketimet për vlerësimin e performancës së pedagogëve bëhen në fund të çdo semestri ose përpara sezonit të provimeve. Vlerësimi nga ana e studenteve organizohet nga NJSBCZHK në bashkëpunim me njësitë bazë dhe personelin administrativ të UMSH. Ky vlerësim realizohet nëpërmjet pyetësorëve, ku studentët shprehin mendimin e tyre për programin e studimit, cilësinë e mësimdhënies dhe metodologjinë e ndjekur nga pedagogu.</p> <p>NJSBCZHK dorëzon Rektorit dhe Zyrës së Burimeve Njerëzore rezultatet e vlerësimeve dhe rekomandimet përkatëse, që synojnë përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në UMSH.</p> <p>Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës bashkëpunon me njësitë e tjera të institucionit në angazhimin dhe dhënien e informacioneve të nevojshme për studentët në lidhje me</p>



	mundësitë për punësim, sipas formimit të tyre. Kjo zyrë drejton dhe mbështet studentët gjatë procesit të formimit universitar të tyre, si dhe orienton dhe këshillon ata mbi kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë e zgjedhjeve.
<b>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni mban një bazë të dhënash në lidhje me statistikat vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar në çdo program studimi.</p> <p>Institucioni ka evidenca për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve</p> <p>Institucioni disponon të dhëna të cilat vërtetohen nëpërmjet regjistrimit mësimor, ku pasqyrohet frekuentimi i studentëve në lëndët përkatëse.</p>
<b>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Pranë UMSH funksionon Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe e Karrierës, e cila ndihmon studentët në drejtimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Orientimi për pjesëmarrjen e studentëve në projekte studimore</li> <li>- Orientimi i studentëve për vijimin e studimeve në ciklet e mëpasme të studimit,</li> <li>- Stimulimi i studentëve për pjesëmarrjen në aktivitete dhe konkurse kombëtare e ndërkombëtare</li> </ul> <p>Për disa shërbime të lidhura ngushtë me këshillimin e studentëve, UMSH i është drejtuar shoqërive të specializuara në tregun shqiptar.</p> <p>Në nivel institucioni janë lidhur marrëveshje për kryerjen e praktikës mësimore të studentëve ku një rast i cili mund të përmendet si shembull pozitiv në këtë kontekst është Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme.</p>
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Pranimi dhe vazhdimi i ciklit të parë të studimeve bëhet në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH" akteve nënligjore, Statutit të UMSH, dhe rregulloreve përkatëse.</li> <li>2. Në sekretarinë mësimore egziston dosja personale e secilit student e mbajtur në mënyrë të rregullt sipas parametrevë të kërkuara nga ligji dhe rregullorja e UMSH. Në sekretarinë mësimore gjithashtu egzistojnë të dhëna ku pasqyrohen rezultatet e secilit student sipas lëndëve</li> </ol>	

dhe viteve akademike.

3. Prioriteti i programit të studimit është studenti. Dhënia e informacionit, mbështetja e studentëve si gjatë programit të studimit por edhe pas përfundimit të tij për tu integruar në tregun e punës janë elementë që shoqërojnë studentët.
4. Lidhja e marrëveshjeve me institucione të caktuara për zhvillimin e praktikave mësimore ndihmon studentët për ti përgatitur praktikisht.

Sugjerojmë ngritjen e një database më të konsoliduar mbi të dhënat për punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve

Nga analiza e standarteve të kësaj fushe gjykojmë se institucioni i plotëson ato kryesisht.

**Standardet përmbushen kryesisht**

## **KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.**

### **10. Kërkimi shkencor**


#### **Pjesa përshkimore**

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Institucioni ka ngritur ndër vite disa struktura të kërkimit shkencor, funksionimi dhe organizimi i të cilave përcaktohet nga politikat institucionale dhe mbështetet në rregullore, statut dhe aktet e tjera rregullatore. UMSH ndjek politika specifike dhe bashkëpunon për kërkimin shkencor me faktorë të jashtëm e të brendshëm në mënyrë të institucionalizuar me marrëveshje ose në mënyrë individuale e në grup midis stafit akademik dhe institucioneve të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë. Në nivel institucional ekziston një ndarje e kërkimit shkencor midis Zyrës së Kërkimit Shkencor dhe Qendrës së Projekteve.

Zyra e kërkimit shkencor është përgjegjëse për financimin e kërkimit shkencor, përmes një procedure që buron nga çdo anëtar i stafit akademik dhe kalon përmes departamentit dhe dekanatit, deri tek Zyra e Financës së UMSH-së. Nga ana tjetër Qendra e Projekteve është përgjegjëse për aplikimet dhe implementimin e projekteve shkencore. Ajo e ka filluar veprimtarinë e saj vetëm gjatë vitit akademik 2017-2018. Deri tani raportohet se është aplikuar për 13 projekte, 3 prej të cilëve janë fituar.

Në nivelin e departamentit, e konkretisht të atij të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, kërkimi shkencor ka dy forma: a) ai realizohet në nivel individual dhe me llogaridhënie periodike (ose një herë në vit); b) kërkimi shkencor realizohet edhe në nivel grupi nëpërmjet: i) konferencave





shkencore brenda dhe jashtë vendit; ii) botimeve në revista shkencore me bord shkencor, brenda dhe jashtë (me faktor impakti dhe/ose bord shkencor); iii) bashkëpunimeve midis organizmave publikë dhe jo-publikë. Kjo i jep vlerësimin të punës shkencore dy komponentë: cilësor (revista me faktor impakti) dhe sasior (numër botimesh).

Në nivelin e departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, konstatohet gjithashtu se kërkimi shkencor konsiderohet si përmbledhje e të gjitha kontributeve shkencore të pedagogëve. Vetë departamenti nuk është përfshirë ndonjëherë në projekt kërkimi shkencor, por ai kryhet nga individë brenda departamentit (shembujt e konstatuar përfshijnë pedagogët: Nevila Rama, Kriton Kuçi, Edon Qesari, etj).

Lidhja e kërkimit shkencor me mësimdhënien Marrëdhënieve Ndërkombëtare përbën një nga prioritetet kryesore. Ai kryhet përmes përfshirjes së studentëve në Konferenca Shkencore (si Panairi i Ideve) dhe stafit akademik në botime dhe konferenca. Kualifikimi i stafit akademik ndikon drejtpërdrejt në nivelin e mësimdhënies dhe të literaturës së përdorur.

UMSH ndjek politika të inkurajimit të pjesëmarrjes së stafit akademik në veprimtari kërkimore shkencore, duke siguruar gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe duke mundësuar shkëmbime eksperiencash, brenda dhe jashtë Shqipërisë.


Që prej 2009 UMSH është anëtar i EMUNI (Euro-Mediterranean University) dhe anëtar i EURAS (që prej vitit 2010). Por në RVB nuk del qartazi në pah si kanë kontribuar konkretisht këto dy rrjete në fuqizimin e kërkimit shkencor në departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të dhëna për kërkimin shkencor (Shih Tabelën 19 në Aneks)

Konstatohet se të dhënat e vendosura në dispozicion janë të përgjithshme dhe nuk lidhen në mënyrë të veçantë me punën shkencore në departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare apo programin e masterit shkencor të marrë në shqyrtim.

Numri i botimeve nga PAE i IAL-së është 949, ndërsa projektet kërkimore të fituara (vetëm gjatë vitit të fundit) janë 3. Të treja këto projekte janë aktualisht në fazën e zbatimit. UMSH ka qenë aktiv edhe sa i takon aktiviteteve shkencore, me 7 të tilla dhe me numër të konsiderueshëm pjesëmarrësish, 532. Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor është 174, i bazuar sidomos në Panairin e Ideve, një konferencë studimore studentore, e organizuar çdo vit gjatë tre viteve të fundit.



Konstatohet se të dhënat e dosjes së vetëvlerësimit përputhen kryesisht me gjendjen e konstatuar në institucion. Kështu, analiza në nivel departamenti tregon se kërkimi shkencor ka dy forma: a) individual me llogaridhënie periodike; dhe b) në nivel grupi (përmjet) konferencave shkencore (rrjeti EMUNI konstatohet si shumë aktiv në organizime të tilla); botimeve në revista shkencore me bord shkencor; iii) bashkëpunimeve midis organizmave publikë dhe jo-publikë. Kjo i jep vlerësimit të punës shkencore dy komponentë: cilësor (revista me faktor impakti) dhe sasior (numër botimesh). Në nivelin departamenti konstatohet se kërkimi shkencor konsiderohet përmbledhje e kontributeve shkencore. Vetë departamenti nuk është përfshirë ndonjëherë në projekt kërkimi shkencor, por kjo zhvillohet nga stafi. Lidhja e kërkimit shkencor me mësimdhënien kryhet përmes përfshirjes së studentëve në Konferenca Shkencore si Panairi i Ideve dhe stafit akademik në botime dhe konferenca.

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Institucioni ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të tjera. Këto përfshijnë: i) institucione publike, si bashkitë, institucionet qendrore sic është Akademia Diplomatike e Ministrise se Jashtme; ii) dhomat e tregtisë; iii) universitete të huaja si London Academy of Diplomacy; iv) apo kompani dhe grupe biznesi. Megjithatë falë këtij bashkëpunimi ka një prezencë të kënaqshme të pjesëmarrjes së lektoreve të huaj në leksione të hapura. Mbetet për t'u forcuar një lidhje më e drejtpërdrejtë dhe e qartë midis këtyre institucioneve dhe IAL-së

UMSH është anëtare i EMUN-it, rrjetit të universiteteve të Mesdheut dhe EURAS ndërmjet të cilave është përpjekur të krijohet marrëdhënie bashkëpunimi që nxisin shkëmbimin akademik, programet e përbashkëta dhe mobilitetin si të pedagogëve ashtu edhe të studentëve. Megjithatë, mobiliteti i personelit akademik dhe sidomos studentëve lë akoma për të dëshiruar dhe ka një pjesëmarrje relativisht të ulët në projekte ndërkombëtare sic janë Erasmus+ të cilat ndihmojnë për të rritur angazhimin dhe bashkëpunimin me partnere akademike ndërkombëtare. Për momentin pjesëmarrja në programe ndërkombëtare është relativisht e ulët dhe informacioni i ofruar nuk paraqet një strategji të qartë për të shpjeguar se si mund të kapërcehet kjo vështirësi.

UMSH ka një seri bashkëpunimesh me mjaft institucione dhe aktore publike dhe private siç janë Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë apo Dhoma Kombëtare e Avokatisë me të cilat ka hartuar

edhe marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikave mësimore apo edhe për të krijuar mundësi punësimi në të ardhmen. Megjithatë lidhjet me tregun e punës për programin në fjalë janë relativisht të pazhvilluara dhe nuk ka një rol të universitetit për të lehtësuar punësimin e studenteve nëpërmjet kontakteve institucionale të zhvilluara me parë me sektore strategjike për punësimin e studenteve të kësaj dege.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**


- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (Shih Tabelën 20 në Aneks)
- Numri i pjesëmarrësve në total në rang institucioni në projekte kombëtare apo ndërkombëtare është 23. Ndërsa ka dhe një numër të lartë leksionesh apo seminaresh me lektorë të huaj të ftuar në institucion (rreth 218 orë mësimore). Gjithashtu një komponent tjetër i matshëm i bashkëpunimit ndërkombëtar është numri i pjesëmarrësve në trajnime kërkimi shkencor, i cili është 23 në rang institucioni. Një numër i konsiderueshëm gjithashtu pjesëmarrësish në aktivitete jashtë vendit është 120 në nivel institucioni dhe 52 në nivel departamenti.
- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (plotëso te dhenat ne aneks)

IAL ka zhvilluar një sërë bashkëpunimesh me institucione dhe organizata, mes të cilave Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Akademia Diplomatike e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, Bashkitë e Durrësit, Gjirokastrës, Tiranës, Sarandës, apo OJF si Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve në Shqipëri. Nga organizatat ndërkombëtare apo qendrat akademike mund të konstatohen marrëveshje me London Academy of Diplomacy, Universita LUM, University of East Anglia, etj.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- Eksperti konstaton se ka një përputhje të plotë dokumentacioni midis atij të depozituar në mbështetje të Dosjes së Akreditimit dhe atij të konstatuar gjatë vizitës në institucion.

#### **Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</b>	
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</b>	



<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit kryhen në përgjithësi në mbledhjet e departamentit dhe takimet shkencore midis pedagogëve. Gjithashtu një shkëmbim i vazhdueshëm i eksperiences me qëllim organizimin e punës shihet si një mekanizëm për të nxitur ndërmjet kolegeve marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p> <p>Institucioni ka një ndarje të qartë të detyrave dhe ka zhvilluar disa mekanizma të analizës së tyre, si ai i punës-kërkimore ashtu dhe i ngarkesës së mësimdhënies (Aneksi A).</p>
<p><b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka vendosur/lidhur mjaft marrëveshje bashkëpunimi me univesitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, si edhe me aktore të institucionale dhe të biznesit. Gjatë vizitës në institucioni u kërkua dhe na u ofrua një listë e plotë me leksione të mbajtura nga pedagogë të huaj pranë UMSH. Këto leksione të hapura përbëjnë një komponent të bashkëpunimit shumëplanesh (si nga ana akademike ashtu edhe persa i takon shkëmbimit të studenteve).</p> <p>Në marrëveshjet institucionale të paraqitura ka mjaft marrëveshje bashkëpunimi kuadër ku përfshihet edhe mundësia për kryerjen e praktikës.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ka një numër të madh marrëveshjesh kuader me institucione publike, akademike dhe kompani e aktorë biznesi</li> <li>2. Këto marrëveshje duhet të jenë më të qarta e të fokusohen më shumë në materializimin e përfitimeve konkrete të institucioneve.</li> </ol> <p><b>Standardet përmbushen</b></p>	



## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

### **I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË**

Në përgjithësi institucioni i ka plotësuar rekomandimet e lëna si detyra ose sugjerime nga akreditimi i mëparshëm. Rekomandimi që lidhet me pasurimin e bibliotekës është përmbushur plotësisht, pasi biblioteka e institucionit ka shtuar ndjeshëm numrin e teksteve, duke e pasuruar atë sidomos me tekstet bazë mësimore. Gjithashtu institucioni ka përmbushur edhe rekomandimin mbi forcimin e gjuhës angleze, duke e përfshirë atë në vitin e tretë përmes modulit specifik të gjuhës angleze për marrëdhëniet ndërkombëtare (ndonëse pa e kthyer atë ende në kriter specifik për pranimin e studentëve, pasi bazuar në legjislacionin aktual studentët e nivelit Bachelor nuk e kanë të detyruar zotërimin e një diplome gjuhe të huaj). Më tej institucioni ka përmbushur edhe rekomandimin për të rekrutuar më shumë staf të brendshëm në nivel institucional.

Nga ana tjetër, rekomandimet lidhur me forcimin e bashkëpunimit me grupet e interesit dhe sektorin publik janë plotësuar kryesisht, pasi ka nevojë të intensifikohen më tej për të qenë sa më të vlefshme për studentët e pedagogët e departamentit. Po ashtu kryesisht është përmbushur dhe rekomandimi për fuqizimin debatit shkencor në nivel institucional, ndonëse rekomandohet të intensifikohet më tej kjo përpjekje.

Së fundi, rekomandimi i zgjerimit të listës së lëndëve me zgjedhje, i lënë nga akreditimi i mëparshëm, është plotësuar pjesërisht, pasi ky program studimi nuk përmban në programin e tij lëndë me zgjedhje por ato ju bëhen të mundura studentëve nga programet e tjera të studimit brenda këtij Fakulteti.

### **II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES-PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).**

#### **a. Pika të forta:**

1. Përmbushja e kritereve ligjore të rekrutimit të stafit akademik të programit të Bachelorit në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci dhe të raportit të stafit akademik, mbështetës dhe administrativ me numrin e studentëve.
2. Krijimi i NJSBCZHK për garantimin e cilësisë së brendshme.
3. Transparenca në vlerësimin e stafit akademik.



4. Përgatitja e një programi në nivele të larta shkencore që ndërthur disa degë të tjera (si shkencat politike dhe ato juridike).
5. Numri i lartë i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, universitete, qendra kërkimore, etj.

**b. Pika të dobëta:**

1. Mungesa e standardizimit dhe përditësimit të silabuseve.
2. Mungesa e një baze të dhënash për punësimin/punësueshmërisë e studentëve të diplomuar nga institucioni gjatë viteve të para të karrierës.
3. Përfshirja e kufizuar e stafit në kërkim shkencor dhe mobilitetin shkencor i stafit akademik nëpërmjet shkëmbimeve me qendra ose universitete jashtë vendit, në rajon apo Evropë.
4. Mungesa e balancës gjinore në stafin akademik të programit.

**c. Mundësitë:**

1. Përditësimi i literaturës së lëndëve bazë të programit me autorë bashkëkohorë, të përkthyer në gjuhën shqipe.
2. Forcimi i lidhjeve me tregun e punës nëpërmjet afrimit të studentëve.
3. Rritja e përfshirjes së studentëve në aktivitetet shkencore të departamentit.
4. Përfshirja në hapësirën e kërkimit shkencor evropian e stafit akademik dhe atij kërkimor mbështetës.

**d. Pengesat:**

1. Njohuritë e kufizuara në fushën e projekteve kërkimore evropiane.
2. Paqëndrueshmëria e tregut shqiptar të punës.

**e. Rekomandime:**

1. Rekomandohet një politikë më e balancuar gjinore në perspektivën e punësimit të stafit akademik dhe atij mbështetës.
2. Rekomandohet një proces i ndërtimit të standardeve të hartimit dhe monitorimit të silabuseve nga departamenti dhe Zyra për Sigurimin e Cilësisë dhe Zhvillimin e Kurrikulave.
3. Rekomandohet ndërtimi i një baze të dhënash të tilla, të qëndrueshme në kohë, e cila do t'i shërbejë procesit të ndjekjes së karrierës profesionale të studentëve dhe ndërtimit në një hark kohor prej rreth një dekade të një rrjeti "Alumni" të institucionit.



4. Rekomandohet ndërmarrja e iniciativave për t'u përfshirë më intensivisht në rrjetet evropiane të kërkimit shkencor, si dhe në shkëmbimet e stafit akademik nëpërmjet projekteve Erasmus të BE-së apo projekteve të tjera.

**Overview analysis of External Evaluation Report based on SWOT (Strengths, Weaknesses, Opportunities and Threats)**

**a. Strengths:**

1. One of the main strengths of the program under periodic evaluation is the fulfillment of the legal criteria for the recruitment procedures of academic and other administrative and technical staff, in compliance with the number of students registered in the program.
2. The establishment of Internal Quality Assurance Unit, supervising and guaranteeing internal quality.
3. Transparency in the evaluation process of academic staff.
4. The development of a Bachelor program on International Relations and Diplomacy of high scientific standards, in combination with other disciplines, such as political and juridical sciences.
5. The increased number of agreements with other institutions in Albania and abroad, with universities, research centers, etc.

**b. Weaknesses:**

1. Lack of standardization and update of course syllabi.
2. The lack of a database for students' employability for a period of at least five years after their graduation from the institution.
3. The limited inclusion of students in scientific research within the department and/or faculty.
4. The lack of gender balance among the academic staff of this program.

**c. Opportunities:**

1. Updating the basic and/or mandatory literature of the program with contemporary authors, translated in Albanian.
2. Strengthening relations with the labor market.
3. Including students in the scientific activities of the department.



4. Taking more initiatives to integrate the department/faculty or the academic staff more into the European research area.

**d. Threats:**

1. Limited know-how on European research projects.
2. The instability of Albanian labor market, which makes it even more difficult for students of social sciences, including those of international relations, to integrate.

**e. Recommendations**

1. We recommend a more gender balanced recruitment policy for the future academic staff.
